

AKT-THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BONAAVENTURA”SHPK.

Sot me date 23.01.2025 te poshtëshënuarit :

Znj Artena Llani e datëlindjes 02.03.1994, lindur ne Weilheim Gjermani dhe banuese në Tirane, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal J45302046D

Z. Bonaventura Fezza e datëlindjes 20.03.2000, lindur në Nocera dhe banues në Tirane, identifikuar me dokument identifikimi: Pasaporte me numër personal YC2227214

Në bazë të nenit 230/2 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Asambleja e Përgjithshme (Ortaketi), sot në datën 23.01.2025 perpilon kete Akt Themelimi per themelimin e shoqërisë “BONAAVENTURA”SHPK, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Pjesa e përgjithshme

Akti i themelimit, statuti, dhe Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, rregullojnë organizimin dhe funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “BONAAVENTURA”SHPK.

KREU I

Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimtarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit, Përgjegjësia e Ortakeve

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin “BONAAVENTURA”SHPK

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakeve të shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare “BONAAVENTURA”SHPK ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “BONAAVENTURA”SHPK do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Tiranë, Rr.e Vilave, Kompleksi Sunrise rezidence ,Zona 1, Njësia 1, nr.10.



NENI 4
Objekti i Veprimtarisë

4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në:

Ne **fushën e turizmit, hoteleri dhe guida turistike** brenda territorit të vëndit.

NENI 5
Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “**BONAAVENTURA**”SHPK do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare “**BONAAVENTURA**”SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vëndit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakut

7.1 Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “**BONAAVENTURA**”SHPK dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

NENI 8
Administratori

14.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

14.2 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakët e shoqërisë . Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

14.3 Administratori ka këto të drejta dhe detyra:

- kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Ortakët e shoqërisë;
- përfaqëson shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortakëve të Shoqërisë për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

- raporton në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve;
- kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj apo të urdhëruara me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

14.4 Administratori i Shoqërisë ka të gjitha kompetencat e tjera të cilat mund ti delegohen atij nga Ortakët, nëpërmjet prokurës.

Administrator i shoqërisë është Znj. Artena Llani e datëlindjes 02.03.1994, lindur në Weilheim Gjermani dhe banuese në Tirane, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal J45302046D për një periudhë 5 vjecare.

KREU II

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit

NENI 9

Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “BONAAVENTURA” SHPK është 10.000 lekë .

8.2 Ortakët e shoqërisë janë :

Znj Artena Llani qe zotëron nje kuote me vlere 5.000 leke, qe eshte 50% e vlerës se kapitalit

Z. Bonaventura Fezza qe zotëron nje kuote me vlere 5.000 leke qe eshte 50% e vlerës se kapitalit

8.3 Kontributet që përbëjnë 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga Ortakët e shoqërisë.

KREU III

Riorganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

NENI 10

Riorganizimi i Shoqërisë

9.1 Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

9.2 Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (të Ortakëve).

NENI 11

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

10.1 Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Të Ortakëve).

Në rast prishje shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.

10.2 Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 12

11.1 Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt Themelimi do të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ky Akt Thmelimi hartohet dhe firmoset në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES

Artena Llani

Artena Llani


Bonaventura Fezza

Bonaventura Fezza
